

**VENDIM**  
**Nr.465, datë 16.4.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.260, DATË 18.4.2007 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR BOTIMIN, SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E  
TEKSTEVE SHKOLLORE, TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9, 56 e 63, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.260, datë 18.4.2007, të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Fjalja e dytë, e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“Këto tekste blihen me fondet e Buxhetit të Shtetit, shpërndahen nga botuesit drejtpërdrejt në shkolla dhe ruhen në bibliotekën e shkollës, si pronë e saj.”.
2. Pas pikës 4, shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:  
“Çmimet e teksteve shkollore, të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, indeksohen, çdo vit, në përputhje me rritjen e inflacionit, me çmimin e letrës dhe të përbërësve bazë të kostos së tyre, të publikuara nga INSTAT-i.”.
3. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“6. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, fondet e miratuara për kompensimin e çmimit të teksteve shkollore ia jep blerësit/nxënësve, për blerjen e teksteve shkollore si “transferte tek individët”.”.
4. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“7. Procedurat e përdorimit dhe të shpërndarjes së fondeve buxhetore, të miratuara si “trasferte tek individët”, për blerjen e teksteve shkollore, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.”.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**